



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT



INSTITUTI I HISTORISË
PRISHTINË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH
SIGURIMIT TË SHETIT**

**INSTITUTI I HISTORISË
“ALI HADRI”
PRISHTINË**

Nr. 395 Prot. Datë 29/05/2018

Nr. 39 Prot. Datë 29/05/2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit Tiranë (më poshtë AIDSSH), përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;

dhe

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë (më poshtë IH), përfaqësuar nga Prof.As.Dr. Gjon Berisha;

Nisur prej interesit të përbashkët të dy Institucioneve palët bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”).

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj **Marrëveshje** është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë represive të regjimit komunist dhe veçanërisht të ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve.

Neni 2

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin të Autoritetit nr.21, datë 09.05.2017, ligji nr. 04/L-037 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës”, ligji nr. 04/L-135, datë 28.03.2013 “Për veprimtarinë kërkimore – shkencore”, si dhe Statusi i Institutit të Historisë “Ali Hadri”, miratuar nga Këshilli Drejtues i Historisë, aprovuar nga MASHT nr. 3837, datë 20.10.2015.

Neni 3

Sfera e bashkëpunimit

AIDSSH dhe IH “Ali Hadri” angazhohen të bashkëpunojnë në kryerjen e studimeve shkencore dhe edukimin qytetar si dhe në aktivitetet e organizuara prej secilës palë, sipas programeve të miratuara në bashkëpunim bilateral ndërmjet dy Institucioneve.

Neni 4

Të drejta dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj **Marrëveshje**, **AIDSSH dhe IH “Ali Hadri”** kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave dhe formularëve të aplikimit, dokumente dhe materiale arkivore që i përkasin periudhës së komunizmit dhe që i nevojiten IH “Ali Hadri” në funksion të veprimtarisë së punës përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në respektim të kërkesave të parashikuara në nenin 36 dhe 37 të ligjit nr. 45/2015;
2. të bashkërendojnë punën për kërkimin shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe të dokumentacionit tjetër arkivor që disponon AIDSSH;
3. të bashkëpunojnë në veprimtarinë shkencore - kërkimore, në kuadrin e nismave rajonale, ballkanike, evropiane dhe botërore;
4. të informojnë njëri –tjetrin për çështje të cilat paraqesin interes të përbashkët në fushën e veprimtarisë shkencore – kërkimore;
5. të bashkërendojnë punën për edukimin qytetar nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të asaj periudhe;
6. të vënë në dispozicion të njëra - tjetrës botime, publikime, studime që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit;
7. të informojnë njëri – tjetrin për përmbajtjen e dokumenteve kryesore që disponojnë dhe kanë karakter dhe interes për studim dhe hulumtim, në përputhje me kriterin e rëndësisë historike kombëtare;
8. të bashkëpunojnë punën për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve, konferencave, workshop, etj., me objekt politikën represive të shtetit komunist;

9. të ndërtojnë projekte studimore e botuese të përbashkëta, të kryejnë hulumtime të përbashkëta në arkivat shqiptare dhe të huaja për periudhën e regjimit komunist;
10. të realizojnë botime dokumentare dhe popullarizuese të përbashkëta;
11. të bashkëpunojnë për përhapjen e dijeve dhe të vlerave në shoqëri, nëpërmjet mediatizimit të tyre, si dhe formave të tjera të transmetimit të informacionit;
12. të kontribuojnë bashkërisht për mbledhjen dhe studimin e materialeve burimore, klasifikimin dhe arkivimin e tyre;
13. të bashkëpunojnë për zhvillimin e teknikave dhe të metodave për ruajtjen dhe restaurimin e vlerave;
14. të bashkëpunojnë për transmetimin e dijeve të fituara nga kërkimi shkencor të studentët dhe shkencëtarët, nëpërmjet formimeve të përparura.

Neni 5

Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH dhe IH “Ali Hadri”** do të caktojnë nga një person kontakti, të cilët do të informojnë palët të paktën 2 herë në muaj për zbatimin e marrëveshjes.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Neni 6

Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH dhe IH “Ali Hadri”** apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 7

Mirëbesimi

1. **AIDSSH dhe IH “Ali Hadri”** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 8

Afati i marrëveshjes

1. Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 9

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë** dhe dy të tjera në **Institutin e Historisë IH "Ali Hadri", Prishtinë**.

PËR

Autoritetin për Informimin mbi

Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit -Tiranë

PËR


Institutin e Historisë


"Ali Hadri" - Prishtinë

Stentiana SULA

KRYETARIA E AUTORITETIT



Prof. Dr. Gjon BERISHA

DREJTORI I INSTITUTIT






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 385 / 2 Prot

Tiranë, më 29 . 05 . 2018



V E N D I M

138 datë 29 . 05 . 2018

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 29 . 05 . 2018, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Znj. Gentiana Sula	Kryetare
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Marenglen Kasmi	Anëtar
Z. Simon Mirakaj	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, Kosovë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", Nenet 1, 8, 17 dhe 35 të Rregullores "Për Organizimin dhe Funkionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2017 të Autoritetit.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi projekt-marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri", Prishtinë Kosovë,

V Ë R E N

Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" në nenin 7 të tij ndër të tjera përcakton se, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si Institucion, i pavarur, është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj.



Në pikën 1, të nenit 10, të ligjit nr. 45/2015 janë përcaktur detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit, të cilat kanë të bëjnë me:

“a) grumbullimin e dokumenteve të ish- Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj; b) vlerësimin, renditjen, evidentimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, sipas rregullave dhe parimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat; c) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të këtij ligji; ç) dhënien e informacioneve e të njoftimeve mbi dokumentet, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimin e tyre për kërkuesit; d) mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve; dh) informimin e individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.”

Sa më sipër, Autoriteti ka prioritet informimin e individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara sipas ligjit. Ndërsa, në bazë të ligjit nr.45/2015 dhe në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, apo të edukimit qytetar, Autoriteti informon kërkuesit për qëllime kërkimore dhe historike mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit, duke respektuar kërkesat e neneve 36, 37 dhe 38 të ligjit nr. 45/2015.

Autoriteti me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 ka miratuar Rregulloren “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” ku në nenin 17 të tij parashikohet shprehimisht se: *“AIDSSH-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka të drejtë të marrë nga autoritetet publike të gjithë ndihmën, informacionin, si dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij, në përputhje me Ligjin për Informimin për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.*

- 1. AIDSSH-ja bashkëpunon me organizata të huaja, rajonale dhe ndërkombëtare që synojnë mbështetjen e procesit të transparencës mbi të kaluarën komuniste dhe viktimat e diktaturës.*
- 2. AIDSSH-ja bashkëpunon me konsulentë vendas apo të huaj, institucione publike, organizata partnere, vendase apo të huaja, për përmirësimin dhe modernizimin e veprimtarisë së tij, si dhe për organizimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme.*
- 3. Për qëllime të informimit të publikut dhe përfshirjes së grupeve të interesit në procese konsultuese, AIDSSH-ja bashkëpunon me institucione, organizata të huaja, ndërkombëtare apo vendase, me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe median.*
- 4. AIDSSH-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucionet publike vendas dhe të huaj si dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.*

Nga ana tjetër legjislacioni i Kosovës ligji nr. 04/L-135, datë 28.03.2013 “Për veprimtarinë kërkimore – shkencore”, në nenin 1 të tij parashikon shprehimisht se: *“1. Veprimtaria kërkimore-shkencore është me interes të veçantë publik e shtetëror dhe pjesë përbërëse në hapësirën shkencore ndërkombëtare.*

2. Veprimtaria kërkimore-shkencore është punë hulumtuese sistematike që bëhet për kërkimin dhe zhvillimin e njohurive të reja, shfrytëzimin dhe zbatimin e tyre në praktikë.

3. Veprimtaria kërkimore-shkencore, transferi i dijes dhe teknologjisë dhe inovacionit përfshin:

3.1. kërkimet shkencore zhvillimore dhe publikimin e rezultateve të tyre;

3.2. aftësimin e kuadrove për punë kërkimore shkencore dhe zhvillimore;

3.3. transferin e dijes dhe teknologjisë;

3.4. njohjen dhe promovimin e inovacionit që del si rezultat i kërkimeve shkencore;

3.5. ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore-shkencore që i ndihmon përparimit ekonomik, teknologjik, kulturor dhe social të vendit.”

Ndërsa në nenin nenin 14, pika 1 të ligjit nr. 04/L-135, datë 28.03.2013 “Për veprimtarinë kërkimore – shkencore” ndër të tjera parashikohet ushtrimi i veprimtarisë kërkimore – shkencore të Institutit të Historisë, sipas të cilit: “Instituti kërkimor-shkencor ka këtë veprimtari: 1.1. ushtron veprimtarinë kërkimore-shkencore; 1.2. kujdeset për ngritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore; 1.3. organizon dhe përparon veprimtarinë në fushën e publikimeve si dhe të informimit kërkimor- shkencor; 1.4. bashkëpunon me institucionet kërkimore-shkencore të vendit dhe të botës; 1.5. angazhohet në veprimtarinë kërkimore-shkencore, në përputhje me prioritetet e Programit Kombëtar të Shkencës duke bashkëpunuar reciprokisht me institucionet e tjera; 1.6. zbaton rezultatet e kërkimit shkencor si një masë për rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës; 1.7. merret me promovimin dhe transferimin e teknologjive të reja në bazë të arritjeve shkencore; 1.8. merret me promovimin e integritetit të sistemit shkencor të Kosovës në hapësirën evropiane të kërkimit shkencor (ERA)” 1.9. merret me ndërlidhjen e shkencës dhe arsimit të lartë nëpërmjet bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet tjera të arsimit të lartë”.

Në këto kushte, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, në kuadër të detyrave që ligji nr. 45/2015 i ngarkon dhe duke patur parasysh se edhe legjislacioni mbi bazën e të cilit funksionon Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë ka në fokus të saj veprimtarinë e kërkimore – shkencore, vlerëson si tepër të domosdoshme lidhjen e kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Lidhja e një marrëveshje bashkëpunimi midis dy Institucioneve do t’i shërbejë Autoritetit gjatë ushtrimit të detyrave të parashikuara në nenin 7 dhe 10 të ligjit nr.45/2015. Marrëveshja ka për qëllim të saj institucionalizimin e marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë represive të regjimit komunist dhe veçanërisht të ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve dhe veçanërisht bashkëpunimin në veprimtarinë shkencore - kërkimore, në kuadrin e nismave rajonale.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara, Autoriteti vlerëson se, Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë gjen mbështetje ligjore në legjislacionin shqiptar ligj,

PËR KËTO ARSYE


Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të



Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe nenit 17 të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2014 të Autoritetit, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

VENDOSI

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë Kosovë.
2. Dërgimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për vazhdimin e procedurave Institutit të Historisë Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë Kosovë.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARJA

Gezgjana Sula

ANËTAR

Albin Hoxha

ANËTAR

Dr. Marenglen Kasmi

ANËTAR

Simon Mirakaj